

Data 10.08.2026

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: Objekti i Prokurimit: “Ndërhyrje për përmirësimin e aksesit, konektivitetit & mobilitetit rajonal dhe lokal: Përmirësimi dhe Rehabilitimi i Rrugës së Aksesit të Fshatit Pilur nga Rruga Nacionale e Lumit të Vlorës dhe i Rrugës së Spitalit, Peqin”.

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 353,353,566.94 Lekë pa TVSH. Programi IVR, me kod projekti 26AB001

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45000000-7.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a) të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimi sipas shtojcës 8)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **financiare 2023, 2024, 2025** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlogaritur e kontratës në procedurën e prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe pika 2/b e nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë monetar dhe të ulët monetar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entitet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bazuar në nenin 61 të ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave nr.26, datë 8.9.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave nr.26, datë 8.9.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar: “Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuar në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor. 2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.”.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2023, 2024, 2025** të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nën 41, pika ”b”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave nr.26, datë 8.9.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 61 të ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave nr.26, datë 8.9.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar: “Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuar në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor. 2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja b” të Ligjit nr. 1009/2009: “Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale apo të konsoliduara, përpara publikimit të tyre: ”b) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike, të cilat në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vjet radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të

mëposhtëm: i. totali i aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse arrin ose e kalon shumën prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh; ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh; iii. ka mesatarisht të paktën 50 (pesëdhjetë) të punësuar gjatë periudhës kontabël.”

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a, plotësohet nga anetari i cili ka përqidjen me të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anetaret e tjere të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqidjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Per të vertetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vertetime të leshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shenohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Shënim: OE/BOE, për punët e ngjashme të realizuara që shtrihen pjesërisht brenda periudhës 5 (pesë) vjeçare, duhet të paraqesin dokumentacionin përkatës provues që vërteton qartë pjesën e punimeve të realizuara brenda kësaj periudhe, si dhe vlerën monetare të punimeve të ekzekutuara gjatë saj.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar në sektorin privat, duhet të paraqiten vertetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shenohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me:

- Kontraten/at e Siper marrjes
- Fature tatimore të situacionit përfundimtar të deklaruar në organet tatimore
- Situacioni përfundimtar
- Akt kolaudimi

Shënim: OE/BOE, për punët e ngjashme të realizuara që shtrihen pjesërisht brenda periudhës 5 (pesë) vjeçare, duhet të paraqesin dokumentacionin përkatës provues që vërteton qartë pjesën e punimeve të realizuara brenda kësaj periudhe, si dhe vlerën monetare të punimeve të ekzekutuara gjatë saj.

Argumentimi: Kërkesa e mesipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe nenin 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e

fundit, qe jane brenda vlerave kufi te percaktuara ne nenin e sipercituar.

Percaktimi i vleres se kerkuar per kontratat e ngjashme argumentohet si me poshte:

Pasi vlera e parashikuar e kontrates, eshte mbi kufirin e ulet monetar. Vlera per pune te ngjashme perben nje nivel te mjaftueshem pervoje duke patur parashysh objektin dhe vleren e kontrates.

Pervoja e meparshme eshte element shume i nevojshem qe garanton autoritetin, se operatoret ekonomike mbi bazen e vleres se puneve te ngjashme zoterojne kapacitete per te zbatuar kontraten me sukses sipas nje standarti te pershtatshem cilesie. Ne mbeshetje te nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se "Oferta mund te paraqitet nga nje bashkim operatoresh ekonomike, sipas percaktimit te pikave 2 dhe 3, te nenit 14, te LPP-se, ku njeri prej te cileve i perfaqeson te tjeret gjate procedures dhe, ne rast perzgjedhjeje, edhe gjate zbatimit te kontrates. Ne oferte duhet te percaktohet pjesa e sherbimit, punes ose furnizimit, qe do te kryeje secili nga anetaret e ketij bashkimi nepermjet nje kontrate bashkepunimi te hartuar ndermjet paleve.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet te paraqese licencen profesionale - te shoqerise, te vlefshme per zbatimin e punimeve objekt kontrate, leshuar nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjise bazuar ne formatin e miratuar me Vendim te Keshillit te Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008 "Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve. Licenca duhet te permbajë kategoritë e punimeve të kontratës si me poshtë:

PER PUNIMET E PERGJITHSHME TE NDERTIMIT

NP 1	C	Punime gjermimi në tokë.
NP 4	D	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.
NP 5	A	Punime nëntoksore, ura e vepra arti.
NP 11	A	Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.

PER PUNIMET SPECIALE TE NDERTIMIT

NS 1	A	Punime për prishjen e ndërtimeve
NS 6	A	Sinjalistika rrugore jo ndriçuese.
NS 7	A	Barrierra dhe mbrojtje rrugore.
NS 8	A	Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri.
NS 9	B	Punime strukturorë speciale.
NS 18	A	Punime topogjeodezike

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të leshuara nga vendi i origjinës, prandaj Ministrisë së Infrastruktures dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhenies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, date 16.01.2008).

ARGUMENTIMI LICENCAT

Kerkesa e mesiperme është percaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Për -prokurimin publik", nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, date 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhenies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", i ndryshuar. Të dhënat për licencat e

mesiperme jane vendosur referuar bazes ligjore per ndertimet, ligjit nr. 8402 date 10.9.1998 "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit" te ndryshuar, neni 8 percakton "Zbatimi i punimeve te ndertimit kryhet vetem nga persona juridike, private ose publike, vendas ose te huaj, te pajisur me licencen perkatese, per zbatim punimesh ndertimore. Zbatuesi i punimeve mban pergjegjesi dhe eshte i detyruar te realizoje punimet e ndertimit, ne perputhje me lejen e ndertimit, projektin, kushtet teknike te zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet te siguroje cilesine e materialeve te ndertimit dhe produkteve te ndertimit, te cilat duhet te plotesojne kerkesat e projektit ne perputhje me standartet kombetare ose europiane.

Kategorite jane kerkuar bazuar ne zerat dhe vlerat e punimeve, si me poshte:

Kategori a e kerkuar		Pershkrimi i kategorise sipas legjislacionit te fushes	Zerat e punimeve qe parashikohen te kryhen ne preventiv, qe perfshihen ne kategorine perkatese	Niveli i klasifikimi t sipas kategorise perkatese	Vlera e punimeve, sipas kategorise perkatese
NP 1	C	Punime germimi ne tokë.	Mbushje me shkemb te germuar me pare Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet Germim shkemb i coptuar me ekskavator 1.0 m ³ , shkemb, ne themele gjeresi >2 m, me shkarkim ne mjet Germim shkemb mesatar me çekiç me ekskavator me zinxhir 3 Germim shkemb i forte me çekiç me ekskavator me zinxhir 3 Germim shkemb sek i lire, me mina te vogla, me ekskavator 1 m ³ + transport Rrafshim skarpate ne germim, ekskavator 0.5 m ³ Transport dheu me auto deri 5.0 km Mbushje me material te germuar ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri Germim dheu me ekskavator zingjir, 0.5 m ³ , ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk ne mjet	51-100 milion lekë	62,455,174
NP 4	D	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aerportuale.	Cilindrim kasonete me rul Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri Shtrese stabilizant t=10cm Struktura monolite betoni C 25/30 Struktura monolite betoni C 20/25 Struktura monolite betoni C 12/15 F.V. Tuba plastmasi ø 100 H / Izolim me emulsion, 2 duar bitum F.V. Bordura betoni 15x25cm Shtrese rere Shtrese asfaltobetoni me zall lavatrice, 4cm, me mak Shtrese binderi me granil gur kave, 6cm, me makineri Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e	101-200 milion lekë	177,900,72 3

			rruges, perhapur e ngjeshur me makineri Shtrese asfaltbetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri F.V. Bordura betoni 15x30cm Trotuar, me 6 cm beton, me pllaka Struktura monolite betoni C 16/20 Nenshtrese zhavori F.V. Hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 10mm F.V. Hekur betoni i zakonshem Ø > 12mm Mur me tulla te plota zak, deri 3m, llaç perzier M 25 Shterese çakelli i imet		
NP 5	A	Punime nëntoksore, ura e vepra arti.	Mur guri mbajtes e themele, llaç çimento M50 Gabiona me rrjete teli te zinguar e gure kave 1x1x1 m Gabiona me rrjete teli te zinguar, gure kave 1x1x1.5 m Tombino me tuba betoni Ø 1000, mbi shtrese betoni Tombino me tuba betoni Ø 1500, mbi shtrese betoni Puse kontrolli 1x1x1.5m Pusete shiu 40 x 60, h = 100 cm, me kapak gize Pusete shkarkimi 80 x 80, h = 100 cm Pusete shkarkimi 80 x 80, h = 200 cm F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=250mm F.V. Tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=200 mm F.V. Tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=250 mm Pusete shkarkimi 80 x 80, h = 1-1.5 m Pusete shkarkimi 80 x 80, h =1.5-2.0 m	0-20 milion lekë	14,107,222
NP 11	A	Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve e linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.	F.V. Ndricues Smart VP CL1 CR M-S 250W GG FAE 44004, me llampe 250W 230V F.V. Shtylla metalike per ndricim, H=7m, d=160mm F.V. Elektroda tokezimi te xinguar 50x3mm L=150cm F.V. Pusete elektrike kontrolli PVC 40x40x40cm F.V. Kuader komandimi komplet me santeri+fotoelement F.V. Percjellesa Cu te izoluar me gome per ndricim, ne tubot e vendosur me pare, sexion 16mm2 F.V. Kabell FG7OR 0.6/ 1KV, 5x6mm2 F.V. tub fleksibel me 2 shtresa D=63mm per elektrik F.V. tub fleksibel me 2 shtresa D=75mm per linjen rezerve (2 tuba)	0-20 milion lekë	2,776,700

NS 1	A	Punime për prishjen e ndërtimeve	Prerje bime te vogla $\varnothing \sim 10\text{cm}$ Prishje struktura prej betoni Prishje struktura prej guri Prishje mur blloqe betoni	0-20 milion lekë	1,761,458
NS 6	A	Sinjalistika rrugore jo ndriçuese.	F.V. Tabele katrore normal me $A=60$ F.V. Tabele drejtkëndore (tregimi)($A \times B$) e zvogëluar 40×60 Vijezim shirita gjatesor dhe anesor me gjeresi 12 cm, Termoplastike (sprajt) Vijezimet e kalimit te kembesoreve. Bikomponente (paste) F.V. Sinjale "emër rruge" $L \times H$ e vogël 60×20 F.V. Tabela trekendore e vogel me $A = 60$ F.V. Tabela tetekendore normal me $A-B$, 90-30 F.V. Tabele rrethi "detyrim" normal me $D = 60$ F.V. Tuba te brinjezuar HDPE SN8 $d=315$ mm F.V. Tuba te brinjezuar HDPE SN8 $d=500$ mm F.V. Tuba te brinjezuar HDPE SN8 $d=600$ mm	0-20 milion lekë	9,778,088
NS 7	A	Barrierra dhe mbrojtje rrugore.	F.V. Guardrail- N2 anesore me 2 valez. ne 1 ane, W3 F.V. Fundore guardrail me 2 valez.	0-20 milion lekë	20,754,949
NS 8	A	Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri.	F.V. Konstruksiione metalike te thjeshta. F.V. Rrethim me kangjella metalike me $h=1\text{m}$ (sipas detajit)	0-20 milion lekë	3,727,699
NS 9	B	Punime strukturorë speciale.	Mbrojtja e shpateve nga renia e gureve me rrjete teli heksagonal 6×8 dhe diameter 2.2-2.4 mm te veshur me galfan (Zn-5%Al) me bordature anesore $\varnothing 3.4/3.0$ mm. Ankera $\varnothing$ ne tunele, periodik	21-50 milion lekë	33,169,378
NS 18	A	Punime topogjeodezike	Referuar projektit te zbatimit dhe relacionit teknik	0-20 milion lekë	-

2.3.3 Operatori ekonomik pjesemarres, per realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet te disponoje **personelin kryesor**, si me poshte:

- 2 (dy) Inxhinierë Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Elektrik
- 1 (një) Inxhinier Mekanik
- 1 (një) Inxhinjer Hidroteknik
- 1 (një) Inxhinjer Mjedisi
- 1 (një) Inxhinier Gjeodet

Per te deshmuar permbushjen e kriterit 2.3.3 operatori ekonomik duhet te paraqese:

- Diploma
- CV

- Kontrata e punes

ARGUMENTIMI I STAFIT

Ne baze te pikes 4, te nenit te 77, te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik" dhe neni 39 pika 6/c VKM nr.285, date 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", me one te ketij kriteri kerkohet qe operatoret ekonomike te deshmojne qe kane personelin e nevojshem te kualifikuar per realizimin me sukses te kontrates. Kriteri per Stafin, lidhet ngushtesisht me objektin e kontrates, specifikimet teknike, raportin teknik dhe volumet e punimeve. Nevoja per inxhinieret ne objekt eshte e diktuar nga pervoja dhe legjislacioni per punimet e ndertimit. Mungesa e ketij stafi pothuajse ne c;do rast rezulton ne realizim jashte afatit, jashte normave dhe me cilesi te dobet te objekteve. Numri i stafit kryesor teknik eshte percaktuar nga pikepamja e natyres teknike te kontrates me qellimin per te patur nje rezultat sa me te mire ne mbarevajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatoret ekonomike duhet te vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, si dhe personelin e nevojshem, per te zbatuar kontraten. Drejtuesi i projektit eshte pergjegjes per ndertimin objektit ne perputhje me kushtet teknike te zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen ne pune brenda kushteve te kontrates

Per permbushjen e ketij kriteri, operatoret ekonomike duhet te vetedeklarojne disponimin e personelit kryesor ne Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit, sipas shtojces nr. 8. Formulari i vetedeklarimit duhet te permbaje kerkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, i kerkon ofertuesit te kualifikuar i pari, dorezimin e dokumenteve provuese.

Punimet apo veprimtarite konkrete per te cilat kerkohet ekspertiza e tyre profesionale jane:

Inxhinier Ndërtimi	Punime gërmimi në tokë. Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale. Punime nëntoksore, ura e vepra arti. Punime për prishjen e ndërtimeve Sinjalistika rrugore jo ndriçuese. Barrierra dhe mbrojtje rrugore. Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri. Punime strukturorë speciale. Punime topogjeodezike
Inxhinier Elektrik	Ndërtime për nënstacione, gabinet e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike
Inxhinier Mekanik	Punime mekanike
Inxhinier Hidroteknik	Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre.
Inxhinier Mjedisi	Punime të inxhinierisë së mjedisit.
Inxhinier Gjeodet	Punime topogjeodezike

2.3.4. Operatori ekonomik duhet te disponoje punonjes te specializuar/te kualifikuar, si me poshte:

1(nje) punonjes te disponoje certificate si "Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune ne perputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Per sigurine dhe shendetin ne pune" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Per miratimin e rregullores "Per sigurine ne kantier". Per te deshmuar permbushjen e ketij kriteri, operatoret ekonomike duhet te paraqese:

- Diplome/certificate
- CV

Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikojë prezencën në objekt të personelit të mesipër dhe/ose të kërkojë ndryshimin/zyvendësimin e tyre me staf me kualifikime të njëjta ose me të larta, në rast konstatimi të shkeljeve të rregullave/normave perkatese. Në rast perseritje mund të merren masa për ndërprerjen e kontratës.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetedeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetedeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetedeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. _Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Argumentimi 2.3.4: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pikë 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa e mesipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier" si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit". Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi perkates në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e perkohshëm ose të levizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikeqyrjes. Operatori/et ekonomik/e, që gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të ketë/në kualifikimet dhe dokumentat perkatese lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimin të mjedisit, për rastë ndotjesh sic; parashikon VKM-ja nr.312/2010. Rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit janë detyrim ligjor për çdo subjekt tregtar person fizik apo juridik për parandalimin dhe pakesimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimit të cilësive të jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat perkatese të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë rekomandohet të jetë në kantier për minimizimin e aksidentëve në punë.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 52 persona, numri i punonjësve duhet të disponohet për secilin muaj, për periudhën 3 muajore nga momenti i hapjes së ofertave e vertetuar kjo me:

- Vertetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën 3 muajore nga momenti i hapjes së ofertave.

* Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. _Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

ARGUMENTIMI NR PUNONJESVE

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pikë 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialistë i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktoret, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e

punes dhe pagen minimale te lejuar qe duhen per te permbushur kontratesn. Numri i punonjesve dhe qendrushmeria e tyre ne pune me koheshtrirje (3 mujore nga momenti i hapjes, tregon besueshmeri per autoritetin qe, operatori do te permbushe kontraten. Deshmia e kerkuar per numrin e fuqise punetore te operatorit ekonomik e nevojshme per ekzekutimin e objektit te kontrates, eshte dokument qe verteton kapacitetin teknik dhe profesional te operatorit, persa kohe jane ne perpjesetim me natyren dhe permasat e kontrates. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjesve ne regjistrin e sigurimeve eshte nje detyrim ligjor i punedhenesit e parashikuar nga Kadi i Punes, per rrjedhoje vertetimi i leshuar nga administrata tatimore e shoqeruara me listpagesat me kete koheshtrirje eshte dokument vertetues per qendrushmerine e te punesuarve, pervojen e tyre, dhe jane ne perpjesetim me natyren dhe permasat e kontrates. Punesimi i nje numri te caktuar, pervec; besueshmerise se operatoreve ekonomik, si nje nga kerkesat themelore te kualifikimit, perpiqet te kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit ne tregun e punes. Po ashtu eshte nje tregues i kualifikimit dhe eksperiences qe duhet te kete kjo kategori e punonjesve. Vendorsja e kriterit duke perfshire dhe stafin teknik, eshte ne perputhje me volumin e punes, natyren dhe terrenin ku do te kryhen punimet. Kriteri per kualifikim eshte vendosur qe t'i sherbeje autoritetit per te njohur gjendjen e kapaciteteve te operatoreve te cilet nepermjet dokumentacionit te vertetojne se zoterojne, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshem, si dhe kapacitetet organizative, gjithcka rie funksion te realizimit me sukses te kontrates.

Analizat teknike jane bazuar ne VKM nr. 216, date 13.4.2023 "Per krijimin dhe funksionimin e sistemit te integruar perinformatizimin e manualit te cmimeve per zerat e punimeve ne ndertim" Bazuar ne kater elementet e struktures se kosos (material, punetori, makineri, transport) zeri fuqi punetore ze rreth 20% te kosos.

Total ore pune = 109,136 ore (referuar oreve te punes sipas preventivit)

Ore/1 dite pune = 8 ore

Total Dite pune punetori = 109,136 ore/8 ore = 13,642 dite pune

Dite pune gjithsej 12 muaj (sipas grafikut te punimeve) * 22 dite/muaj= 264 dite pune

Numri i fuqise punetore 13,642 dite / 264 dite = 52 punetore afersisht.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesemarres, per realizimin e kontrates, duhet te disponoje, mjetet dhe pajisjet e meposhtme ne pronesi ose qira ose kontrate furnizimi.

Nr	Emri i mjetit/pajisjes	Njësi	Sasia	Statusi
1	Eskavator me Goma	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
2	Eskavator me Zinxhir mbi 20 ton	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
3	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtës 10 deri 30 Ton	Copë	6	Ne pronesi ose me qera
4	Kamioncine	Copë	2	Ne pronesi ose me qera
5	Kamion me Vinc min 5 Ton	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
6	Fadroma me goma	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
7	Autobot Uji	Copë	2	Ne pronesi ose me qera
8	Autobetoniere	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
9	Autopompe	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
10	Gjenerator	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
11	Vibrator	Copë	2	Ne pronesi ose me qera
12	Betoniere min 0.5 m ³	Copë	2	Ne pronesi ose me qera
13	Çekiç hidraulik për eskavator mbi 20 ton	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
14	Greider	Copë	1	Ne pronesi ose me qera

15	Asfaltoshtuese	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
16	Autobitumatrice	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
17	Rul Gome-Hekur	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
18	Rul Hekur-Hekur	Copë	1	Ne pronesi ose me qera

Pajisjet dhe mjetet nuk duhet te jene te angazhuara ne asnje kontrate tjeter publike, qe bie ndesh me legjislacionin e fushes se ndertimit, dhe do te angazhohet vetem per realizimin e ketij objekti.

Si deshmi per te vertetuar disponimin e mjeteve dhe pajisjeve teknike ne pronesi/qira /kontrate furnizimi, do te paraqiten keto dokumenta:

- Për mjetet ne pronesi (që shënohen në regjistra publike), duhet të paraqiten;- dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), -plus certifikaten e kontrollit teknik, -siguracionin e mjetit (te vlefshme), vertetimin e pageses per taksat vjetore.
- Për mjetet e siguruar me qira, duhet të paraqiten; -dokumenti qe verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (te vlefshme), vertetimin e pageses per taksat vjetore, kontrata e qirase e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi.
- Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira te tij.

Operatori/et ekonomik ofertues duhet te deklaroje qe te gjitha mjetet dhe pajisjet e pershkruara, do te jene te angazhuara vetem ne kete kontrate. Mjetet te cilat rezultojne te angazhuara ne kontrata te tjera afati i zbatimit te cilave shtrihet pergjate afatit te kontrates objekt i prokurimit jane shkak skualifikimi. Autoriteti Kontraktor gezon te drejten te verifikojte dhe kontrolloje disponueshmerine e ketyre mjeteve si gjate vleresimit te ofertave ashtu edhe gjate zbatimit te kontrates.

* Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit._Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

Autoriteti Kontraktor ka te drejte te kryeje verifikimet e nevojshme mbi vertetesine e informacionit te deklaruar nga operatori ekonomik si me siper ose te kerkoje operatorit sqarime dhe dokumente mbeshtetese per keto sqarime ne perputhje me nenin 24 pika 1 te VKM nr.28 date 19.05.2021 per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik.

ARGUMENTIMI MJETET

Ne baze te pikes 4, te nenit te 77, te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c; dhe 6/d, te VKM nr. 285, date 19.05.2021"Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", me ane te ketij kriteri kerkohet qe operatoret ekonomike te deshmojne qe kane fuqine minimale punetore, te nevojshme per ekzekutimin e objektit te prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, te nevojshme per ekzekutimin e objektit te prokurimit, qe ka ne dispozicion apo qe mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik per te permbushur kontraten.

Per te percaktuar numrin e mjeteve/makinerive te nevojshme per realizimin e kontrates, jane hartuar analizat

teknike, sipas legjislacionit të fushes bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të cmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre" (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018).

Nr	Emri i mjetit/pajisjes	Njësi	Sasia	Emërtimi i punimeve
1	Eskavator me Goma	Copë	1	Punime gërmimi në tokë. Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale. Punime nëntoksore, ura e vepra arti. Punime për prishjen e ndërtimeve Ndërtime për nënstacione, gabinet e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike Sinjalistika rrugore jo ndriçuese. Barriera dhe mbrojtje rrugore. Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri. Punime strukturorë speciale. Punime topogjeodezike.
2	Eskavator me Zinxhir mbi 20 ton	Copë	1	
3	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtës 10 deri 30 Ton	Copë	6	
4	Kamioncine	Copë	2	
5	Kamion me Vinc min 5 Ton	Copë	1	
6	Fadroma me goma	Copë	1	
7	Autobot Uji	Copë	2	
8	Autobetoniere	Copë	1	
9	Autopompe	Copë	1	
10	Gjenerator	Copë	1	
11	Vibrator	Copë	2	
12	Betoniere min 0.5 m ³	Copë	2	
13	Çekiç hidraulik për eskavator mbi 20 ton	Copë	1	
14	Greider	Copë	1	
15	Asfaltoshtruese	Copë	1	
16	Autobitumatrice	Copë	1	
17	Rul Gome-Hekur	Copë	1	
18	Rul Hekur-Hekur	Copë	1	

2.3.7 Kërkesa të tjera të vecanta për kualifikim

Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme:

- EN-ISO 9001 (Sistemi i menaxhimit të cilësive) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Nderkombetare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë
- EN-ISO 14001 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Nderkombetare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë
- ISO 45001 (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Nderkombetare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të leshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vertetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si me sipër; ose të kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për keto sqarime në përputhje me nenin 24 pika 1 të VKM nr.28 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik.

Shënim:

Mbi mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera

*Në mbështetje të nenit 84, pika 7, të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe nenit 90, pika 6, të VKM nr. 285/2021, Autoriteti Kontraktor vlerëson se operatorët ekonomikë **nuk mund të mbështeten***

në kapacitetet e subjekteve të tjera për kriteret që lidhen drejtpërdrejt me realizimin e proceseve kryesore të kontratës, konkretisht:

- *përvojën e mëparshme të ngjashme;*
- *personelin/stafin kryesor;*
- *bilancet vjetore;*
- *licencat profesionale të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate.*

Këto kapacitete konsiderohen thelbësore për realizimin e kontratës, pasi lidhen drejtpërdrejt me organizimin e punimeve, koordinimin e zbatimit në kantier, përputhshmërinë me specifikimet teknike dhe kërkesat ligjore, si dhe kontrollin e cilësisë dhe sigurisë gjatë realizimit të punimeve objekt kontrate. Autoriteti Kontraktor vlerëson se mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera për këto kriteret mund të cenojë realizimin efektiv dhe të besueshëm të kontratës. Për këtë arsye, këto kapacitete duhet të disponohen dhe të angazhohen drejtpërdrejt nga operatori ekonomik ose anëtar i përkatës i BOE që do të realizojë punimet, me qëllim garantimin e përgjegjshmërisë, cilësisë së ekzekutimit dhe minimizimin e riskut gjatë zbatimit të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme është percaktuar bazuar në nenin 79, "Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor" të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar. Për vet natyrën e vecante, vendndodhjes dhe permasat e objektit të kontratës që do të prokurorhet, është tepër e rendesishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kerkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarde që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtesisht me objektin e kontratës përse koha do të pronohej edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomike dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plate të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të leshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kerkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

*Shënim: Përcaktimi i specifikimeve teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

Projekti zbatimit, Specifikimet teknike, raporti teknik, preventivi me zerat e punimeve, grafiku janë hartuar nga subjekt projektues të licencuar dhe janë pjesë e DST.

Ne çdo rast nëse janë përmendur markë prodhimi ose proces i vecantë në dokumentet e tenderit në këtë procedurë prokurimi do të pranohen edhe ekuivalent.

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto ¹ X

Sipas rëndësisë:

- | | |
|---|----------|
| 1. Çmimi | pikët 70 |
| 2. Aftësia organizative, kualifikimi dhe përvoja e stafit për punime specifike shtesë | pikët 10 |
| 3. Periudha e garancisë së punimeve civile dhe pajisjeve (jo më pak se 2 vjet) | pikët 10 |
| 4. Vlera e garancisë së punimeve (jo më pak se 5%) | pikët 5 |
| 5. Siguria në kantier/shëndeti, impakti në mjedis dhe social (PSK) (jo më pak se 3 %) | pikët 5 |

Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

Kriteret e vlerësimit:

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100.

Kriteri:

- | | |
|----------|---------------|
| 1. Çmimi | [0 - 70] pikë |
|----------|---------------|

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përlogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = V_{\min k1} \times P_{\max k1} / O_{k1}$$

P_{k1} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\min k1}$ Vlera më e ulët e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k1}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k1} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Nëse një ose disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, refuzohen pa kërkuar shpjegime

- | | |
|---|--------------|
| 2. Aftësia organizative, kualifikimi dhe përvoja e stafit për punime specifike shtesë | [0 –10 pikë] |
|---|--------------|

¹Shënim. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.

Operatori Ekonomik per te vleresuar per kete kriter duhet të provoje se zotëron merita teknike, aftësi organizimi, kualifikimi dhe përvojën e stafit që është emëruar ne eksperiencat e mëparshme të ngjashme në kryerjen e punimeve dhe volumeve specifike si me poshte:

- *Punime shtresa asfaltike (konglomerat, binder, tapet) me sipërfaqe jo me pak se 51,690 m² për kontrata të kryera gjatë pesë viteve të fundit.*

* Ky është kriter vlerësimi dhe si i tillë operatorët ekonomik nuk do të skualifikohen por do të vlerësohen, bazuar në sasinë dhe përmbushjen e kushtit të afatit 5 vjecar. Kriteri eshte vendosur për të treguar organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës. Vlera e kontratave të mëparshme dhe specifikisht vlera e punime dhe volume te kryera te realizuara, ndikon në disa aspekte të përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë, sikurse janë: i. stabiliteti financiar dhe kapaciteti; -cilësia dhe standardet; -historia e suksesit; -trajtimi i kompleksitetit Për tu vlerësuar për këtë kriter operatori ekonomik/bashkimi i operatorëve ekonomik duhet të plotësojë minimalisht vlerën e kërkuar. Nëse kjo vlerë minimale nuk plotësohet do të konsiderohet se operatori ekonomik/bashkimi i operatorëve ka marrë “0” pikë.

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k2} = O_{k2} \times P_{\max k2} / V_{\max k2}$$

P_{k2} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\max k2}$ Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet (vlera më e lartë e punimeve specifike te kryera)

$P_{\max k2}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k2} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Permbushja e ketij kriteri do te provohet nepermjet situacioneve perfundimtare, aktit te kolaudimit sipas pikes 2.3.1 te Kapacitetit Teknik, dorezimit te detyrueshem te informacionit te përmbledhur sipas formatit bashkelidhur (Aneks 1) dhe cdo dokumentacion provues (sipas rastit) per volumet e kerkuara (leje ndertimi, projekti etj).

Volumet specifike për kontrata të cilat nuk janë kolauduar nuk do të përfshihen në përlllogartje.

Argumentim:

“Punime shtresa asfaltike (konglomerat, binder, tapet) me sipërfaqe jo me pak se 51,690 m² për kontrata të kryera gjatë pesë viteve të fundit.”

Përcaktimi i sipërfaqes minimale prej 51,690 m² synon të garantojë që operatori ekonomik disponon eksperiencë në realizimin e punimeve me përmasa dhe kompleksitet të njëjtë me objektin e

prokurimit, duke dëshmuar aftësi organizative, teknike dhe kapacitete për menaxhimin e punimeve infrastrukturore.

Kërkesa për kontrata të realizuara gjatë pesë viteve të fundit është vendosur për të verifikuar kapacitetin aktual teknik dhe organizativ të operatorit ekonomik, si dhe për të siguruar që eksperiencia e paraqitur reflekton standardet bashkëkohore të realizimit të punimeve dhe volumeve specifike të kerkuara.

Shënim:

Në mbështetje të nenit 84, pika 7, të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 90, pika 6, të VKM nr. 285/2021, për këtë kriter **nuk lejohet mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera.**

Autoriteti Kontraktor vlerëson se aftësia organizative, kualifikimi dhe përvoja e stafit për punime specifike shtesë përbëjnë aspekte kritike të kontratës dhe lidhen drejtpërdrejtë me cilësinë, organizimin teknik dhe realizimin efektiv të punimeve objekt prokurimi.

Për këtë arsye, kriteri duhet të përmbushet drejtpërdrejtë nga operatori ekonomik ofertues ose nga anëtarë i bashkimit të operatorëve ekonomikë që do të realizojë punimet përkatëse.

3. Periudha e garancisë së punimeve civile dhe pajisjeve (jo më pak se 2 vjet) [0–10 pikë]

Ky kriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë e punimeve të kontraktorit, duke qënë se afatet më të gjata detyrojnë këtë kontraktor të kryejë punime me cilësi për mos të qenë i detyruar ti zëvendësojë apo riparojë punimet që do të kryejë. Referuar në nenin 45 të VKM nr.285/2021, kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme bazohet në, kushtet e dorëzimit, si p.sh. datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.

Kontraktori do të garantojë cilësinë e punimeve minimalisht për 2 vjet. Çdo ofertë e paraqitur për më pak se dy vjet do të skualifikohet. Çdo ofertues i cili do të paraqesë një periudhë garancie punimesh dhe paisjesh përfshirë për më shumë se 2 vjet do të vlerësohet si më poshtë:

$$P_{k3} = O_{k3} \times P_{\max k3} / V_{\max k3}$$

P_{k3} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\max k3}$ Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k3}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k3} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Për këtë kriter ofertuesi duhet të paraqesë propozimin e tij sipas formatit bashkelidhur (Aneks 2)

4. Vlera e garancisë së punimeve (jo më pak se 5%)

[0 - 5 pikë]

Ky kriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë e punimeve të kontraktorit, vlerat e garancive më të larta e detyrojnë këtë kontraktor të kryejë punime me cilësi.

- **Autoriteti kontraktor do të mbajë garancinë e punimeve sipas përcaktimeve të legjislacionit për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në vlerën prej minimalisht 5 %.**
- **Çdo ofertues i cili do të ofertojë një vlerë garancie punimesh më të ulët se 5% do të skualifikohet si ofertë e papërgjegjshme e cila nuk respekton përcaktimet ligjore për vlerën e garancisë.**
- **Çdo ofertues i cili do të ofertojë dhe pranojë për mbajtjen e një vlerë garancie punimesh më të lartë se 5% do të vlerësohet si më poshtë:**

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k4} = O_{k4} \times P_{\max k4} / V_{\max k4}$$

P_{k4} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\max k4}$ Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k4}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k4} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Për këtë kriter ofertuesi duhet të paraqesë propozimin e tij sipas formatit bashkelidhur (Aneks 3)

Shënim: Vlera e garancise se punimeve ne % e ofruar nga OE, do te ndalohet nga çdo pagese pjesore ne shumen e caktuar te vleres se situacionit pjesor si garanci e defekteve. Kjo sipas përcaktimeve të kushteve të kontrates, (Shtojca 16 e dokumenteve të tenderit) Neni 10, pika 10.4.

Për këtë kriter ofertuesi duhet të paraqesë garancinë sipas formatit bashkelidhur (Aneks 3)

5. Siguria ne kantier/shëndeti, impakti në mjedis dhe social (PSK) (jo më pak se 3 %)

[0 - 5 pikë]

Për këtë kriter ofertuesi duhet të paraqesë ofertën për vlerën PSK në rubriken specifike/zerin “Siguria në kantier (Plani I Sigurisë e Kordinimit në Kantier PSK, menaxhimin e trafikut dhe kontrollit) sipas Vendimit nr. 216, datë 13.04.2023)”, në preventivin e ofertes:

Standarti gjatë zbatimit të punimeve është i lidhur në mënyrë të posacme edhe me përmbushjen nga ana e kontraktorit të të gjitha masave të marra dhe të ndjekura në mënyrën e duhur, sa i përket ceshtjeve të sigurisë në kantier, shëndetit, impaktin në mjedis dhe social që kanë punimet e kryera. Siguria e shtuar dhe shëndeti në punë ka të bëjë me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes të shëndetit të punëmarrësve, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident, informimin, konsultimin, pjesëmarrjen e balancuar si dhe trajnimin e formimin e punëmarrësve e përfaqësuesve të punëmarrësve në përputhje me legjislacionin përkatës.

Siguria në kantier, përfshin Planin e Sigurisë e Kordinimit në Kantier (PSK), menaxhimin e trafikut dhe kontrollin (më tej shtjelluar në Relacionin Teknik dhe aktet nenligjore përkatëse të referuara). Ky parashikim shërben në mënyrë të vecantë për përmirësimin e kushteve të punës së punëmarrësve, në mënyrë që të shmangen/zvogëlohen aksidentet në punë, sëmundjet profesionale

dhe të përmbushen të drejtat e punëmarrësve për punë të denjë të krahasueshme me vendet e tjera të BE-së.

Për shkak të rëndësisë që paraqesin këto detyrime për kontraktorin është parashikuar një rubrike e vecantë në preventivin e punimeve si zë më vete dedikuar sa më lart. Kjo rubrike bazohet ne Vendimin Nr. 216, datë 13.4.2023 *“Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”* (Neni 13, Pika 3).

Fondi i veçantë për këtë rubrike ne masen jo me pak se 3%, përlllogaritur në përputhje me madhësinë e projektit që do të realizohet sipas percaktimeve të VKM nr. 216 date 13.04.2023. Ky fond parashikohet shprehur në vlerë, në këtë rast **jo më pak se 7,883,107.26 leke pa tvsh për “Përmirësimi dhe rehabilitimi i rrugës së aksesit të fshatit Pilur nga rruga nacionale e lumit të Vlorës” dhe jo më pak se 2,212,708.94 leke pa tvsh për “Rruga e spitalit, Peqin”**. Ofertuesi nuk duhet të plotësojë formularin e ofertës nën vlerën minimale. Kjo vlerë minimale shërben për zbatimin e masave të shtuara për sigurinë në kantier, në zbatim të Vendimit nr. 312, datë 5.5.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, Aneksi VI “Përmbajtja minimale e planit të sigurse në kantieret e perkoheshme e të levizeshme”.

Në vijim, për kriterin: Standarti dhe Cilësia: Siguria në kantier/shendeti, impakti në mjedis dhe social, propozim i ofertuesit do të konsiderohet vlera e ofertuar nga operatori ekonomik për zerin Siguria në kantier (Planin e Sigurisë e Kontraktorit në Kantier PSK, menaxhimin e trafikut dhe kontrollit të shtuar), e përfshirë në ofertën ekonomike të detajuar, konkretisht sipas Shtojcës 2 të DT. “LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT”

- *Kontraktori do të ofertojë për këtë zë (PSK) minimalisht vlera 7,883,107.26 leke pa tvsh për “Përmirësimi dhe rehabilitimi i rrugës së aksesit të fshatit Pilur nga rruga nacionale e lumit të Vlorës” dhe 2,212,708.94 leke pa tvsh për “Rruga e spitalit, Peqin*
- *Çdo ofertues i cili do të ofertojë një vlerë më të ulët se vlera vlera 7,883,107.26 leke pa tvsh për “Përmirësimi dhe rehabilitimi i rrugës së aksesit të fshatit Pilur nga rruga nacionale e lumit të Vlorës” dhe 2,212,708.94 leke pa tvsh për “Rruga e spitalit, Peqin, do të skualifikohet si ofertë e papërgjegjshme (konsiderohet sikur ka sjellë volume pune më pak)*
- *Çdo ofertues i cili do të ofertojë dhe pranojë për mbajtjen e një vlerë PSK – Sigurie në kantier më të lartë se vlera vlera 7,883,107.26 leke pa tvsh për “Përmirësimi dhe rehabilitimi i rrugës së aksesit të fshatit Pilur nga rruga nacionale e lumit të Vlorës” dhe 2,212,708.94 leke pa tvsh për “Rruga e spitalit, Peqin, do të vlerësohet si më poshtë:*

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k5} = O_{k5} / V_{\max k5} \times P_{\max k5}$$

P_{k5} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\max k5}$ Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k5}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k5} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Ofertat anomalisht të ofruara për kriterin: Siguria ne kantier/shendeti, impakti ne mjedis dhe social (PSK)

Në rast kur është një ofertë e vlefshme, oferta konsiderohet anomalisht e ofruar për kriterin “Siguria e shtuar ne kantier/shendeti, impakti ne mjedis dhe social (PSK)”, **kur ofrohet më shumë se dyfishi i vlerës së kërkuar.**

Në rast se janë më shumë se dy oferta, oferta konsiderohet anomalisht e ofruar për kriterin “Cilesia ne punime: siguria ne kantier/shendeti, impakti ne mjedis dhe social” **nëse vlera e saj do të jetë më shume se dyfishi i** mesatares së ofertave të vlefshme.

Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht e ofruar për nën-kriterin “Cilesia ne punimet e kryera: siguria ne kantier/shendeti impakti ne mjedis”, në rastin kur ekzistojnë dy ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

$$\begin{aligned} O & \quad - \text{ (pikët e Ofertës)} \\ Mo & \quad - \text{ Mesatarja e pikëve të ofertave të vlefshme} \\ N & \quad - \text{ Numri i ofertave të vlefshme} \\ PR (R_{rm}) & \quad - \text{ Rritje e mundshme} \\ Mo & = O_1 + O_2 + O_3 + \dots + O_n / N \\ PR & = 200 \% Mo \end{aligned}$$

Vlera e ofertave të ofruara $> PR$ rrjedhimisht oferta është anomalisht e ofruar për nën-kriterin “Cilesia ne punimet e kryera: siguria ne kantier/shendeti impakti ne mjedis”.

Kujdes!!!

Për ofertën që do të konsiderohet anomalisht e ofruar për këtë kriter, ofertuesi do të vlerësohet gjithësesi me të njëjtat pikë sikurse ofertuesi me pikët më të ulëta për këtë kriter.

Në rast se ky ofertues përsëri shpallet fitues, PSK do të përllogaritet në bazë të ofertës së ofertuesit pavarësisht pikëve të marra.

Shembull: PSK është caktuar 15,000,000 lekë. Ofertuesi A ka ofruar 15,000,000 lekë, B 16,000,000 lekë, C 17,000,000 lekë dhe D 55,000,000 lekë. Sipas pikëve për këtë kriter ofertuesin përfitojnë pikët respektivisht A – 1.36 pikë, B – 1.45 pikë, C -1.55 pikë dhe D – 5 pikë të plota.

Pas formulës për anomalisht të ofruar rezulton se ofertuesi D është anomalisht i ofruar për PSK ($200\% MO = 51,500,000 \text{ leke} < 55,000,000 \text{ leke}$) dhe vlerësohet me 0 pike.

Ne rastin kur Ofertuesi D merr piket maksimale per kriteret e tjera vleresuese, pra ne rastin kur Ofertuesi D shpallet fitues vlera per PSK do te jete 55,000,000 leke.

Autoriteti Kontraktor ben likujdimin e vleres se sipercituar per sigurine ne kantier ne cdo situacion mujor referuar peshës respektive/korresponduese te realizimit te punimeve, kjo e shoqeruar me (i) raportin PSK (referuar permbytjes minimale te PSK) hartuar nga Kontraktori e (ii) Mbikqyresit i punimeve dhe (iii) i monitoruar e miratuar nga specialistet e HSE (Health, Safety and Environment) te autoritetit kontraktor.

Theksohet se, nese nga monitorimi i specialisteve te HSE dhe Mbikqyresit te punimeve rezulton se nuk jane zbatuar masat e sigurise ne kantier (kjo nënkupton edhe nëse ka një shkelje të vetme) pervec masave penalizuese referuar KPK dhe KVK te kontrates, vlera korresponduese per kete rubrike nuk do te paguhet për situacionin mujor referues.

